

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME

Për Aktivitetin e Prokurimit:

Nr1 i prokurimit	214-25-6191-5-5-8
Nr i brendshëm	

Sa i përket tenderit për:

“Furnizim me material të ndryshëm zyrtar me shtypë për MPB -Ritender II ”

1. Identifikimi i OPERATORIT EKONOMIK

Emri i Kompanisë: NTSH OFFICE TRADE

Adresa: Prishtine ,10 000

Numri Telefonit: 049/589845

Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj: ARBNORA ALIU

Adresa elektronike: OFFICETRADE2002@YAHOO.COM

Data e parashtrimit të ankesës: 11.07.2025



Nënshkrimi dhe vula:

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit)(Numri i faks-it)

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të ankesës)(Nënshkrimi dhe vula)

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës” apo “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit”, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

Ftesa për ofertim është bërë me datë : 08.07.2025 në ora 17:00 , që i bie me datën 09.07.2025 pasi që dita fillon në ora 08:00 dhe mbaron në ora 16:00 sipas LPP-se ;
Kriteret e Dhënies : Tenderi i përgjegjshëm me Çmimin më të ulët
Hapja e tenderit është me datë : 14.07.2025 ora 14:00
Kërkesa për informacione shtesë : 09.07.2025
Sqarimet e dërguara nga AK me datën : 10.07.2025
Kërkesën për rishqyrtim me datë : 10.07.2025
Pergjigja e kërkes për rishqyrtim date : 11.07.2025
Ankesa në OSHP me datë : 11.07.2025

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po	<input type="checkbox"/>				Jo	<input type="checkbox"/>	
----	--------------------------	--	--	--	----	--------------------------	--

Hapja nuk është bërë në mënyrë

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ? A keni bërë ndonjë reagim me shkrim dhe/ose kërkuar sqarime shtesë nga AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj, si dhe a u është përgjigjur me shkrim AK në lidhje me këtë? Nëse po, ofroni shkurtimisht detaje mbi këtë fakt:

Po	<input type="checkbox"/>				Jo	<input type="checkbox"/>	
----	--------------------------	--	--	--	----	--------------------------	--

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒

Jo ☐

Përmes Kërkesës për Rishqyrtim të datës 10.07.2025 OE NTSH OFFICE TRADE ka paraqitur dëshmitë dhe faktet Autoritetit Kontraktues- MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME se per kete aktivitet ka bere shkelje sa l perkctet specifikimit teknik dhe eshte ne kundërshtim te plotë me Ligjin nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 dhe ligjet tjera ne fuqi , por me daten 11.07.2025 AK – MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME e ka refuzuar kerkesen tone per rishqyrtim.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Shkeljet e dispozitave të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-92, (LPP), janë:Shkeljet e dispozitave të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-92, (LPP), janë:

Neni 1 Qellimi

Neni 6 Ekonomiciteti dhe Efikasiteti

Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi

Neni 28 Specifikimet teknike

Neni 29 Variantet e specifikimeve teknike

Neni 6 i udhëzuesit 02/2024 Afatet kohore

Shkeljet e dispozitave - Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ
për Prokurim Publik 001/2023

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

*AK/Zyra e prokurimit gjate pergaditjes se procedures se prokurimit perkatesisht gjate perpilimit te specifikacionit teknike ka bërë shkelje dhe nuk ka vepruar ne haromoni me : **Ligjin nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092.***

Se pari shkeljen e pare AK e ka bere me afatin e hapjes se tendereve kur vlere e projektit eshte 120,000.00 euro ku cilesohet si vlere e mesme dhe autoriteti kontraktues hapjen e ofertes e ben per 5 dite , ndersa sipas LPP-se afati per hapje te ofertes per vlere te mese eshte 20 dite apo me afat te persheptuar 10 dite.

Shkelja e dyte e AK-se eshte qe kerkesen tone per rishqyrtim e shpall te jashte afatshme.

Ftesa per oferte eshte bere me daten 08.07.2025 ne ora 17:00 , ku sipas LPP-se nje dite fillon ne ora 08:00 dhe mbaron ne ora 16:00 cka i bie qe ftesa llogaritet nga data 09.07.2025. Ne si OE kemi bere kerkesen per rishqyrtim me daten 10.07.2025 dhe pergjigjen e kemi marr me daten 11.07.2025 , andaj ketu nuk e dim se me cfare afate ligjore ka llogaritetur AK qe kerkesa jone per rishqyrtim eshte e jashte afatit kur afati per dergim te ofertes eshte 5 dite.

AK – Ministria e Puneve te Mbrendshme ka vendosur kriteret ne specifikimin teknike Aneks 1 te cilat jane ne kundërshtim me Nenin 6 dhe 7 te LPP-se. AK ka vendosur specifika teknike te cilat diskriminojne nje apo me shume operator ekonomik si dhe eliminon konkurrencen ne mes te operatorëve ekonomik.

AK - Ministria e Puneve te Mbrendshme , ka vepruar ne kundërshtim me Nenin 28 te LPP-se pasi qe per artikujt te cilet ka kerkuar mostra nuk ka ofruar ndonje link apo ndonje moster se si duken artikujt e kerkuar , ndersa tek sot me daten 11 e degjon nje katalog per disa artikuj se si duken ndersa ne kerkesen

tone per sqarime qe kemi kerkuar te kene ndonje foto apo moster na eshte pergjigjur qe nuk kane mostra dhe sot 3 dite para hapjes se tenderit e degjon nje katalog me disa fotografi te cilat edhe nuk duken qarte dhe ne te njeten kohe nuk e shtyn afatin e hapje se tenderit kur edhe kerkohet me ligj qe cdo ndryshim apo dokumente shtese te behet vazhdimi i afatit te hapjes se tenderit pasi qe edhe mostrat te cilat i ka kerkuar AK jane shume te pshtjelluara.

Neni 19.4 Përshkrimi i specifikimeve teknike/Termat e referencës do të jenë të qarta, sakta dhe precize dhe duhet të mos paraqet kufizime të pa arsyeshme, në mënyrë që të mos kufizohet konkurrenca. Specifikimet duhet të përkufizohen në mënyrë që mos të krijojnë paqartësi rreth natyrës së mallrave, punëve ose shërbimeve të kërkuara.

Neni 28.1 Autoriteti Kontraktues do ti perpiloje specifikat teknike ne ate menyre qe ato te jene ne perputhje me qellimin e prokurimit dhe te drejtuara drejt sigurimit te qasjes se me te mire per te gjithë operatoriet ekonomik dhe tenderuesit. Autoriteti kontraktues eshte veçanarisht i ndaluar qe te hartoje specifika teknike qe favorizojne apo diskriminojne nje ose me shume operator ekonomik. Ne kete rast ne si kompani jemi diskriminuar pasi qe specifikat teknike jane te mangeta dhe nuk jane te kjarta dhe kjo bazohet shume sakt qe procedura ne fjale edhe duke u ritenderuar qe 2-3 her pasi qe asnje nga operatoret ekonomik qe marrin pjese ne kete procedure nuk i kane mostrat konfrom specifikave teknike. Kjo mund te ndodhe nje here qe nje operator ekonomik nuk i ka mostrat konfrom specifikave teknike por qe te shpallet 3 her tenderi dhe 2 her te anulohet pasi qe nuk jane mostrat sipas specifikave teknike kjo gje le te nenkuptoj qe nuk eshte faji tek operatoret ekonomik por tek autoriteti kontraktues pasi qe specifikat teknike nuk jane te kjarta dhe te sakta.

Ne te njeten kohe eshte duke u anashkaluar edhe [A002 Versioni i Konsoliduar - Rregullore Nr.002/2024 për Plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik](#) per sa i perket kerkeses se mostrave ku ceket :

Neni 37 Mostrat e tendereve - 37.1 Dokumentet e tenderit në përgjithësi duhet të shmangin kërkesën për paraqitjen e mostrave, pasi kjo kërkesë dekurajon konkurrencën dhe rrit çmimet e ofertës. Përndryshe, tenderuesve duhet t'u 71 RREGULLORE PËR PROKURIMIN PUBLIK – Versioni i konsoliduar kërkohet të konfirmojnë që produkti i tyre plotëson specifikimet e kërkuara dhe në mbështetje të bashkëngjitni çertifikatat e duhura të testimit nga laboratorë të njohur testimi.

Andaj ne kerkojme nga eksepri I lendes apo paneli shqyrtues I OSHP-se qe te largohen mostrat ose te pakten te behet prezantimin i mostrave nga autoriteti kontraktues apo sic eshte cekur edhe tek neni 37.1 te kerkojni nje deklarate per specifikimet e kerkuara dhe ne momentin qe ndonje OE fiton tenderin ti i pergadisin se bashku mostrat – operatori ekonomik me njesin kerkuse.

Kerkesa jone eshte e bazuar pasi qe specifikat te cilat jane te vendosura jane te pakjarta dhe nuk jane te detajuara dhe nuk mund te kerkohen disa mostra te cilat edhe nuk mund te gjinden ne treg, gjithashtu vleresimi i mostrave nga ana e komisionit edhe shume i veshtire pasi qe nuk mundet komisioni te i cilesoj si mostra te dobeta apo qe nuk i permbushin specifikat teknike pasi qe nuk jane eksperta te asaj lamiye edhe dihet qe sipas LPP-se vlereimin e tyre mund ta beje ndonje laborator apo ne ndonje ekspert qe eshte i lamise se caktuar.

Gjithashtu disa artikuj te cilat jane kerkuar mostra jane vendosur dimensione tjera , ndersa nga AK eshte kerkuar format tjeter : *Gjithashtu specifikim teknik i pergaditur nga AK eshte i pa kjart dhe i manget.*

Art 29.Nuk ka specifika te kjarta teknike ;

Art.36. Plaket xhami ne forme flake, xhami me dimension 17.5x10 cm ne xham me kuti formë libri A5, sipas

kërkesës se AK-se për vendosjen e llogosë apo mbishkrimin. Eshtë e pakuptimt pasi që është kerkuar plaket ne form flake me dimensione 17.5 x 10 dhe kerkon format A5- keto dimensione jane per format tjeter e jo per formatin A5 , ku dihet qe flaka ka modele te ndryshme dhe nuk ka foto se ku duhet te bazohemi

Art 52. Eshtë i pa kuptushem pasi që nuk ka skice te sakt me dimeziona ku dimezionet që i ka cekur Kopërtina për mirënjohje A4 me lëkurë sky me llogo 46.5x 31.5 me llogo të MPB-se 300gr color. dimezionet jane per format A2 , ndersa e ka cekur qe kopertina duhet te jete a4.

Te nderuar per te gjitha produktet që nuk prodhohen ne industri por prodhohen ne menyre artizanale duhet te kete terma, specifika dhe diagrama me dimensione te sakta dhe duhet te i kete specifikat teknike shume te sakt pasi që gjithmonde do te kemi problem edhe ne pergaditjen e mostrave sic edhe po ndodh ne kete aktivitet te prokurimit.

Gjithashtu tenderi ne fjal eshte duke u shpallur qe tri(3) here pra jane dy anulime - te cilat jane te bazuara sipas AK qe mostrat jane te kualitetit te dobet dhe nuk jane konfrom specifikave teknike dhe shihet qarte qe kjo nuk eshte ne fajin e operatoreve ekonomik pasi qe specifikacioni teknike eshte shume i manget.

Andaj mbesim me shprese dhe te keni mirkuptim qe kerkea jone do te aprovohet dhe te largohen mostrat – te kerkohet nje deklarata me shkrim qe do i permbushin specifikat teknike ku mund te kerkohet edhe nje rritje e sigurimit te ekzekutimit ne rast se nuk behet sipas specifikimit teknik ose te na i paraqitnje nje moster se si duket artikulli te cilet jeni duke i kerkuar.

Bazuar në të gjitha këto të dhëna të shënuara me lartë dhe dëshmitë e bashkangjitura kërkojmë nga Eksperti I OSHP-se si dhe Paneli i OSHP-se ,që ankesen tone të merrë si të bazuar dhe të faktuar.

Faleminderit per mirekuptim

Me Respekt.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës:

Mohimi i të drejtës tonë për te marre pjese ne kete aktivitet te prokurimit dhe mundesia per te nënshkruar kontratën dhe fitimet e pritura, shpenzimet e bëra me rastin e përgatitjes te Kërkeses për Rishqyrtim dhe shpenzimet e bëra me rastin e përgatitjes se ankeses ne OSHP.

10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

Ftesa për ofertim është bere me date : 08.07.2025

Kriteret e Dhënies : Tenderi i përgjegjshëm me Çmimin më të ulët

Hapja e tenderit është me date : 17.07.2025 ora 14:00

Kerkesa per informacione shtese : 09.07.2025

Sqarimet nga AK me date : 10.07.2025

Kerkesen per rishqyrtim me date : 10.07.2025

Pergjigja e kerkes per rishqyrtim date : 11.07.2025

Ankesa ne OSHP me date : 11.07.2025

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*